

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUTIT TË STUDIMEVE
PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI PËR VITIN 2019

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur dhe vlerësuar rolin e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në grumbullimin, administrimin, ruajtjen dhe dokumentimin e materialeve të kësaj periudhe në Shqipëri;

Duke njohur bashkëpunimin e këtij Instituti me institucionet kërkimore, kulturore, arsimore dhe institucionet e tjera vendase e të huaja për shkëmbimin e informacionit e të përvojës lidhur me objektin e punës së Institutit;

Duke konsideruar se detyrat kryesore të punës së këtij Instituti kërkojnë mbështetjen e vazhdueshme të organeve shtetërore, medias, shoqërisë civile dhe partnerëve, në funksion të ruajtjes së kujtesës sonë kolektive;

Vlerëson veprimtarinë e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri gjatë vitit 2019 në drejtim të:

Sensibilizimit publik dhe institucional për rëndësinë e trashëgimisë materiale të periudhës komuniste dhe vitalizimin e kësaj trashëgimie përmes dokumentimit filmik, teknikave digjitale dhe ekspozitave.

Informimit publik për krimet dhe dhunimin e të drejtave të njeriut gjatë regjimit komunist, përmes hulumtimit, evidentimit, dokumentimit, publikimit dhe analizimit mbi baza shkencore të këtij informacioni.

Evidentimit të rasteve të rezistencës morale dhe fizike në burgje dhe kampet e punës përmes konferencave promemorie dhe botimeve.

Vazhdimësisë së projekteve afatgjata për kërkimin arkivor dhe dëshmitë verbale, siç është pasurimi i databazës dhe arkiva e videoregjistrimeve dhe aktivitete derivate të tyre.

Forcimit të impaktit publik të institucionit përmes aplikimit të formave interaktive dhe lehtësisht të aksesueshme, siç janë Muzeu Virtual dhe Ekspozita Fotografike.

Ndërkombëtarizimit të historisë së komunizmit në Shqipëri përmes bashkëpunimit me artistë të huaj në projekte të veçanta.

Kuvendi rekomandon që Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri për vitin 2020 të përmirësojë punën në këto drejtime:

- Në funksion të transparencës dhe informimit, të bëjë publike në faqen *online* të institucionit, si dhe në raportin vjetor që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë të gjithë vendimmarrjen e Bordit Drejtues dhe Këshillit Shkencor, sipas detyrave që i ngarkon ligji nr. 10242, datë 25.2.2010 “Për Institutin e Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri”, duke respektuar kufizimet e legjislacionit të fushës për mbrojtjen e të dhënave konfidenciale;

- Të përditësojë në faqen *online* Rregulloren e Brendshme të Institutit me ndryshimet e bëra si rezultat i përmbushjes së rekomandimeve të KLSH-së dhe të publikojë procedurën e rekrutimit të Këshillit Shkencor;

- Të përfshijë në raportimin vjetor burimet e tjera të të ardhurave të Institutit, përveç të ardhurave buxhetore, si dhe mënyrën e përdorimit të tyre;

- Të shprehet në raport për ankesat kundër vendimeve të Institutit dhe vendimmarrjen e Bordit lidhur me to;

- Raporti vjetor të paraqitet në Kuvend i shoqëruar me vendimin e Bordit për miratimin e tij;

- Të rrisë aksesin në sektorin e edukimit shkollor të të gjitha niveleve, me gjetjen e formave sa më interaktive të përcjelljes së historisë së komunizmit, për një impakt sa më të fuqishëm tek të rinjtë.

Miraturar në datën 4.6.2020.

KRYETAR
Gramoz Ruçi